

Në dhjetor nis gjykimi
në mungesë ndaj tre
të akuzuarve për krime
lufte në Kosovë FAQE 4



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

POROSIA E SHEFES SË KE-së: KOSOVA TË NDËRTOJË INSTITUCIONE TË FORTA DHE T'I ULË TENSIONET FAQE 5



Presidentja e Komisionit Evropian (BE), Ursula von der Leyen, pas takimit të presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se është e rëndësishme për Kosovën të vazhdojë të ndërtojë institucione të fuqishme dhe t'i "ulë tensionet" në vend. Po ashtu, ajo ka thënë se Kosova duhet t'i përfundojë hapat e nevojshëm për të përfituar nga Plani i Rritjes

OPINION

PROCESET E PAKOORDINUARA
KOMBËTARE DHE KONSTRUKTET
E KOORDINUARA
ANTIKOMBËTARE F. 7

Milazim
KRASNIQI



AKTUALE

**UNË JAM UÇK
PROTESTË
GJITHËKOMBËTARE
NË TIRANË**

Për lirinë, për të ardhmen,
për drejtësinë!

MË 17 TETOR 2025
NË OREN 17:00
SHESHI "SKËNDERBE" TIRANË



**SHOIPTAR GUBETINI: LE TË JEMI
BASHKË, KRAH PËR KRAH,
MË 17 TETOR NË SHESHIN
"SKËNDERBEJ" F. 6**

**AMBASADORI I RI GJERMAN:
KOSOVA, PARTNERE E
RËNDËSISHME E GJERMANISË F. 3**

EKONOMI



**LANSOHEK SISTEMI DIGJITAL
I INSPEKTIMEVE TË PUNËS
NË KOSOVË F. 8**

**AZEMI: KËTË VIT 26 PUNËTORË
KANË VDEKUR NË VENDIN E PUNËS F. 8**

SPORT

**28 KOMBËTARE SIGURUAN
KUALIFIKIMIN NË BOTËROR F. 11**

**DREJTËSI PËR
ÇLIRIMTARËT:
OSMANI, SPIROPALI
DHE BALLA DALIN
NË MBËSHTETJE
TË PROTESTËS
NË TIRANË F. 4-5**



**MOTORISTËT
NISEN NGA
PREKAZI DREJT
HAGËS NË
MBËSHTETJE
TË LIDERËVE
TË UÇK-së F. 5**

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

NË DHJETOR NIS GJYKIMI NË MUNGESË NDAJ TRE TË AKUZUARVE PËR KRIME LUFTE NË KOSOVË

PRISHTINË, 15 TETOR - \Gjykata Themelore në Prishtinë ka njoftuar se ka caktuar 22 dhjetorin datë për mbajtjen e seancës për shqyrtimin fillestar lidhur me aktakuzën për krime lufte në Kosovë ndaj Dushan Gavranit, Zoran Sharac dhe Zharko Cvetanoviq. Aktakuza për krime lufte kundër popullatës civile ndaj tyre është ngritur më 30 dhjetor të vitit të kaluar nga Prokuroria Speciale e Kosovës, e cila ka propozuar që gjykimi për këtë rast të zhvillohet në mungesë për shkak të pandehurit janë të paarritshëm për autoritetet e drejtësisë në Kosovë. “Për këtë arsye, përmes kësaj komunikate u bëhet thirrje të pandehurve Dushan Gavranit, Zoran Sharac dhe Zharko Cvetanoviq, që të paraqiten dhe

të dorëzohen para organeve të ndjekjes së Republikës së Kosovës”, ka njoftuar Gjykata Themelore në Prishtinë. Sipas aktakuzës të ngritur nga Prokuroria Speciale, dyshohet se Gavranit në cilësinë e personit zyrtar në territorin e Komunës së Gjilanit, në periudhën janar-korrik 1999, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të parandaluar apo për të raportuar për vrasjet, plagosjet dhe djegien për së gjalli të viktimave civile shqiptare, marrjen peng, rrahjet, maltretime dhe dëbimin e popullatës civile shqiptare në fshatrat Kokaj, Llovçë, Pogragjë dhe Uglar. Ndërsa për Cvetanoviqin, Prokuroria ka thënë se ai dyshohet se së bashku me një grup, që e ka quajtur kriminal, ka marrë pjesë në vrasjen e tetë



civilëve shqiptarë, gjithashtu në rajonin e Gjilanit. “Konkretisht dy nga këto viktima i kanë vendosur në grumbull drurësh, ku një nga ta është djegur për së gjalli”, kishte thënë

Prokuroria Speciale në njoftimin e saj për ngritjen e aktakuzës. I pandehuri tjetër, Zoranb Sharac, dyshohet se në cilësinë e mjekut të Spitalit rajonal të

Gjilanit nuk i kishte ofruar ndihmë mjekësore viktimës N. R. më 5 prill 1999, për të cilin Prokuroria pretendon se ishte plagosur vetëm pse ishte shqiptar. Prokuroria Speciale ka ngritur një sërë aktakuzash të tjera në mungesë në ditët e fundit, kryesisht për krime të kryera gjatë luftës në Kosovës. Në korrik të këtij viti kjo prokurori ngriti aktakuzë në mungesë kundër 21 të dyshuarve për dëbimin me forcë të mbi 800 000 civilëve shqiptarë nga Kosova gjatë luftës. Gjykimet në mungesë, sipas sistemit të drejtësisë në Kosovë, mund të zhvillohen vetëm me kusht që prokuroria dhe gjykata t'i kenë shteruar të gjitha mjetet për ta siguruar praninë e të akuzuarit.

RUTTE: PO PUNOJMË ME BE-NË PËR MBUROJËN EVROPIANE KUNDËR DRONËVE

BRUKSEL, 15 TETOR - Shefi i NATO-s, Mark Rutte, ka thënë para takimit me ministrat e mbrojtjes, se aleanca ushtarake dhe Bashkimi Evropian (BE) po punojnë së bashku për të krijuar “një mur për dronët” për t'i mbrojtur vendet anëtare nga inkursionet e dronëve. I pyetur nëse po dyfishohen përpjekjet për këtë çështje, Rutte ka thënë se BE-ja dhe NATO-ja kanë role të ndryshme: NATO-ja ofron kapacitete në aspektin ushtarak, ndërsa BE-ja e ka fuqinë e butë të tregut të brendshëm dhe siguron që të jenë të disponueshme fondet. Fokus i takimit në Bruksel të ministrave të Mbrojtjes të NATO-s pritet të jetë edhe forcimi i mbështetjes për Ukrainën. Në takim do të marrë pjesë edhe sekretari amerikan i

Mbrojtjes, Pete Hegseth, teksa presidenti amerikan, Donald Trump, është duke e shqyrtuar mundësinë që ta furnizojë Kievin me raketa me rreze të gjatë veprimi. Takimi i NATO-s vjen pasi Moska ka sfiduar NATO-n me një sërë shkëlqesh të hapësirave ajrore në Poloni dhe Estoni, duke rritur frikën se konflikti në Ukrainë mund të zgjerohet. Po ashtu, ka pasur detektive të dronëve edhe në afërsi të ndërtesave ushtarake në shtete të tjera, që kanë nxitur autoritetet t'i mbyllin aeroportet. Të gjitha këto ngjarje kanë rritur shqetësimet se Rusia po synon ta shtyjë NATO-n që të reagojë. Ministrat e mbrojtjes, po ashtu, pritet të përqendrohen edhe në përpjekjet për t'i mbushur

boshllëqet në krahun lindor të aleancës, pasi NATO-ja është detyruar të përdorte raketa të shtrenjta për t'i rrëzuar dronët rusë që hynë në Poloni. Pas incidenteve, NATO-ja ka nisur një mision për ta forcuar mbrojtjen e saj, por disa vende afër Rusisë kanë kërkuar që të ketë një përgjigje më të fuqishme. Aleanca ushtarake perëndimore, po ashtu, është duke synuar ta përshejtojë zhvillimin e aftësive kundër dronëve dhe të inkorporojë në mbrojtjen e saj teknologjinë e lirë që Ukraina përdor. Edhe BE-ja do të zhvillojë një takim me ministrat e saj të Mbrojtjes mbrëmjen e së mërkurës. Bloku ka propozuar krijimin e një “muri për dronët” për t'u përballur me kërcënimet. Megjithatë, në mesin e shteteve



evropiane ka skepticizëm, siç është rasti i Gjermanisë, për këtë propozim dhe, po ashtu, ka frikë se blloku evropian mund të hyjë në fushëveprimtarinë e NATO-s. Nisma për dronët është një nga projektet kryesore që BE-ja është përqendruar si pjesë e një përpjekjeje më të

gjërë për ta përgatitur bllokun për një konflikt të mundshëm me Moskën në vitet në vijim. BE-ja pritet t'ua paraqesë ministrave një udhëzues për planin e saj, që shpreson se do të miratohet gjatë një samiti të udhëheqësve që do të mbahet javën e ardhshme.

IZRAELI VENDOS TA RIHAPË PIKËKALIMIN NË RAFAH, HEQ DORË NGA MASAT KUNDËR HAMASIT

JERUSALEM, 15 TETOR - Izraeli ka vendosur ta rihapë pikëkalimin në Rafah, që lidh Rripin e Gazës me Egjiptin, dhe ta lejojë transferimin e ndihmës humanitare në enklavë. Njoftimi vjen pasi Hamasi - grupi palestinez i shpallur organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian - ka dorëzuar mbetjet mortore të katër pengjeve, raporton transmetuesi publik izraelit, “Kan”.

Lirimit të pengjeve i ka paraprirë një paralajmërim nga Izraeli se do ta përgjysmonte numrin e kamionëve me ndihma që do të lejoheshin të hynin në Gazë, por kjo masë është anuluar pas dorëzimit të katër trupave të pengjeve të vdekura. Të martën presidenti amerikan Donald Trump i ka bërë thirrje Hamasit t'i lirojë pengjet e vdekura, duke thënë se puna për ndalimin e luftës nuk ka përfunduar.



Hamasi ka liruuar më 13 tetor të 20 pengjet e gjalla izraelite, ndërkaq Izraeli ka liruuar afër 2 000 palestinezë që mbaheshin në burgjet në Izrael. Po atë ditë autoriteteve izraelite u janë dorëzuar mbetjet mortore të

katër pengjeve. Lirimi i pengjeve dhe armëpushimi në Gazë është pjesë e fazës së parë të planit 20 pikësh të paraqitur nga presidenti Trump për paqe në enklavën palestineze. Më 14 tetor Trumpi ka thënë se faza e dytë e planit të tij ka nisur. Plani për paqe parasheh çarmatosjen e Hamasit, kërkesë që Izraeli e kishte parashtruar paraprakisht, por ishte refuzuar nga grupi radikal palestinez. Lufta në Gazë ka

nisur më 7 tetor të vitit 2023 pasi Hamasi kishte sulmuar jugun e Izraelit duke vrarë afër 1 200 persona dhe duke rrëmbyer 251 të tjerë. Si pasojë e ofensivës hakmarrëse të Izraelit, në Rripin e Gazës janë vrarë më shumë se 67 mijë palestinezë, sipas Ministrisë së Shëndetësisë në këtë enklavë. Lufta ka shkatërruar pjesë të mëdha të Gazës dhe dy milionë banorët e territorit po përballen me krizë të thellë humanitare.

POROSIA E SHEFES SË KE-së: KOSOVA TË NDËRTOJË INSTITUCIONE TË FORTA DHE T'I ULË TENSIONET

Presidentja e Komisionit Evropian (BE), Ursula von der Leyen, pas takimit të presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se është e rëndësishme për Kosovën të vazhdojë të ndërtojë institucione të fuqishme dhe t'i "ulë tensionet" në vend. Po ashtu, ajo ka thënë se Kosova duhet t'i përfundojë hapat e nevojshëm për të përfutur nga Plani i Rritjes

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 15 TETOR - Shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka qëndruar të mërkurën për vizitë zyrtare në Kosovë. Gjatë kësaj vizite ajo ka takuar ndaras presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, por asnjëra palë nuk është deklaruar për medie.

Për dallim nga Osmani, takimi i shefes së Komisionit Evropian me Kurtin nuk është zhvilluar në qeveri, por në ambientet e Kuvendit për shkak të një vendimi të Bashkimit Evropian. Pas këtyre takimeve ajo ka thënë se është e rëndësishme për Kosovën të vazhdojë të ndërtojë institucione të fuqishme dhe t'i "ulë tensionet" në vend. "Ne mbetemi të përkushtuar ndaj një të ardhmeje

ku që të gjashtë partnerët e Ballkanit Perëndimor do të jenë pjesë e unionit tonë. Për këtë, është e rëndësishme që Kosova të vazhdojë të ndërtojë institucione të forta, t'i ulë tensionet në vend, dhe gjithashtu t'i përfundojë hapat e nevojshëm për të përfutur nga Plani i Rritjes", ka shkruar ajo në platformën "X". Nuk është e qartë se çfarë tensioneve po i referohej von der Leyen në postimin e saj në "X", por autoritetet kosovare janë kritikuar rishtazi nga BE-ja për mbylljen e zyrave në Mitrovicë të Fondit për Sigurime Shëndetësore dhe Fondit për Sigurime Invalidore e Pensionale, që funksionojnë sipas sistemit të Serbisë. BE-ja i kishte bërë thirrje në shtator qeverisë në detyrë dhe institucioneve të tjera relevante të Kosovës të "përmbaheshin nga provokime të tilla dhe veprime të



dëmshme si dhe të konsultohen me komunitetin lokal serb dhe partnerët ndërkombëtarë".

Ndërsa presidentja Vjosa Osmani, pas takimit se me shefen e KE-së, ka bërë me dije se kanë biseduar për çështjen e zbatimit të Planit të Rritjes, masat ndëshkuese të BE-së ndaj Kosovës dhe për integrimin evropian të vendit. "Kënaqësi e veçantë ta mirëpres sërish sot në Republikën e Kosovës presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen. Së bashku diskutuam për zbatimin e Planit të Rritjes, për rëndësinë e heqjes së masave të padrejta ndaj vendit tonë, si dhe për hapat tutje në rrugën drejt integritetit tonë në Bashkimin Evropian. Mbështetja e Komisionit Evropian për Kosovën në këtë proces mbetet thelbësore", ka shkruar Osmani në "Facebook".

Republika e Kosovës vazhdon të mbetet vendi i vetëm nga rajoni që ende nuk e ka statusin e vendit kandidat për në BE, tri vjet pasi bëri kërkesë për t'iu bashkuar bllokut evropian. Gjithashtu, Kosova vazhdon të përballlet me masa ndëshkuese evropiane, të

cilat blloku i kishte vendosur më 2023 për shkak të rritjes së tensioneve në veri të vendit, i banuar me shumicë serbe. Sa i përket Planit të Rritjes së BE-së, një paketë prej 6 miliardë eurosh e miratuar më 2023, Kosova nuk ka mundur të pranojë të holla për shkak të mungesës së një Kuvendi pas zgjedhjeve të shkurtit. Por, tani që Kosova e themeloi Kuvendin e ri javën e kaluar, ajo mund ta ratifikojë marrëveshjen e nevojshme për të filluar t'i pranojë mjetet nga ky plan.

Më 8 gusht të këtij viti, ambasadori i Bashkimit Evropian në Kosovë, Aivo Orav, e kishte informuar Qeverinë në detyrë të Kosovës se zyrtarë të bllokut evropianë nuk do të zhvillonin takime në ndërtesën qeveritare derisa vendi të ketë një ekzekutiv me mandat të plotë.

Sipas letrës së dërguar, vendimi është marrë pas "aktgjykimit të Gjykatës Supreme të 25 qershorit" që e kishte shpallur të pavlefshëm një udhëzim administrativ të nënshkruar nga ministri në detyrë i Financave, Hekuran Murati, pasi kishte argumentuar se nxjerrja e akteve

nënligjore apo udhëzimeve administrative nga ministrat që janë deputetë është e kundërligjshme dhe shkel dispozitat kushtetuese.

Kosova është me ekzekutiv në detyrë pasi që nga zgjedhjet e 9 shkurtit. Kurti është mandatar nga Osmani për ta formuar qeverinë e re dhe ai ka afat deri më 26 tetor që të paraqesë para Kuvendit përbërjen e re qeveritare.

Për zgjedhjen e qeverisë duhen 61 vota dhe Kurti ka thënë se do të zhvillojë diskutime gjatë ditëve në vijim për formimin e shumicës, pasi në bazë të rezulttit zgjedhor, ai nuk mund të qeverisë pa një partner koalicioni.

Vizita e von der Leyen në Kosovë u zhvillua në kuadër të një turneu ballkanik. Ajo paraprakisht vizitoi Shqipërinë, Malin e Zi, Bosnjë-Hercegovinën. Ndërkaq, para se të nisej për në Kosovë, ajo zhvilloi takim me presidentin serb Aleksandër Vuçiq në Beograd. Ndërkaq, turneun në rajonin e Ballkanit Perëndimor do ta përmbyllë po sot në Maqedoni të Veriut ku do të takohet me krerët shtetërorë.



AMBASADORI I RI GJERMAN: KOSOVA, PARTNERE E RËNDËSISHME E GJERMANISË

PRISHTINË, 15 TETOR - Ambasadori i ri i Gjermanisë në Kosovë, Rainer Rudolph, përmes një videoje është paraqitur shkurt për kosovarët dhe për mbështetjen e vendit të tij ndaj Republikës së Kosovës. Ai ka thënë se Gjermania është krenare që ka mbështetur Kosovën e pavarur dhe sovranë dhe se ai do të vazhdojë ta mbështesë integrimin ndërkombëtar të Kosovës dhe atë në Bashkimin Evropian (BE).

"Për ne gjermanët, Kosova është një mike e mirë dhe një partnere e rëndësishme. Dhe ne

kemi qenë krenarë që e kemi mbështetur Kosovën si një komb të pavarur dhe sovran për një kohë të gjatë. Dhe unë dua të mbështes integrimin ndërkombëtar të Kosovës, veçanërisht rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian", ka thënë ai.

Ambasadori i ri gjerman ka thënë se pret "me padurim" t'i njohë njerëzit e Kosovës dhe ta provojë ushqimin e vendit tonë. "Dhe, mbi të gjitha, pres me padurim t'ju njoh të gjithëve juve e këtë vend të bukur dhe ushqimin e tij të mrekullueshëm", ka thënë Rudolph.



PROTESTË GJITHËKOMBËTARE NË TIRANË



DREJTËSI PËR ÇLIRIMTARËT: OSMANI, SPIROPALI DHE BALLA DALIN NË MBËSHTETJE TË PROTESTËS NË TIRANË

Protesta gjithëpopullore që do të mbahet të premten në Tiranë në mbështetje të liderëve të UÇK-së është duke marrë mbështetje mbarëshqiptare. Mbështetje kësaj proteste i ka dhënë presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani. Ajo ka thënë se Kosova kërkon respektim të parimeve më të larta të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe se u jep të drejtë qytetarëve që kërkojnë respektim të këtyre standardeve. Po ashtu, kësaj proteste i kanë dhënë mbështetje kryediplomatja e Shqipërisë, Elisa Spiropali, deputeti i PS-së, Taulant Balla dhe tifozgrupi “Dardanët”

“Por ne kërkojmë që parimet më të larta të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të respektohen. Unë u jap plotësisht të drejtë qytetarëve tanë sa herë protestojnë për të kërkuar respektimin e këtyre standardeve”, ka theksuar Osmani.

Më tutje, Osmani ka thënë se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë luftë e drejtë për liri, për mbrojtje të popullit të pafajshëm, çlirim e mbrojtje të pragut të shtëpisë. Osmani ka thënë se UÇK ka mbrojtur me dinjitet qytetarët e Kosovës, Republikën e Kosovës. “Lufta e UÇK-së ka qenë luftë e drejtë për liri, për të mbrojtur popullin, për ta çliruar Kosovën nga okupimi shekullor dhe luftë që ka pasur në fokus mbrojtjen e pragut të shtëpisë dhe për të mbrojtur qytetarët e pafajshëm. Për këdo që e ka parë me sytë e vetë se çfarë ka ndodhur në luftën e fundit, ka qenë vetëm një agresor dhe ajo ka qenë Serbia, ka qenë një viktme dhe ajo është Kosova, populli i Kosovës. UÇK ka mbrojtur me dinjitet qytetarët e Kosovës, ka mbrojtur me dinjitet

Republikën e Kosovës dhe drejtësinë e kësaj luftë do ta mbrojmë deri në fund”, ka përfunduar Osmani.

Spiropali: Liria ka emrin e çlirimtarëve të djeshëm dhe luftëtarëve të sotëm

Edhe ministrja e Jashtme e Shqipërisë, Elisa Spiropali, ka reaguar për protestën e së premtes në Tiranë, e cila do të mbahet në mbështetje të liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Ajo ka thënë se liria nuk mund të jetë e plotë me pranga në duart e çlirimtarëve. “Zemrat kuqezi kundër padrejtësisë! Në këtë shekull të shqiptarëve, liria nuk mund të jetë e plotë me pranga në duart e çlirimtarëve. Me Thaçin, Veselin, Krasniqin e Selimin në qeli, ndërgjegjja kombëtare nuk mund të jetë e qetë dhe padrejtësia do të ketë ende hise në hakun e shqiptarit. Alkimia djallëzore e shndërrimit të heronjve të djeshëm të moralit dhe aleatëve euroatlantikë, në

vrasës, e kthimit përmbys me truke e trike juridike e të vërtetave historike, shpërblimi i agresorit të djeshëm me rivasjen e viktimës është më shumë se kriminale. Ajo duhet të marrë fund ashtu siç nisi, menjëherë dhe pa kushte”, ka thënë Spiropali.

Ajo ka thënë se “më 17 tetor zemra e shqiptarëve anembanë botës, kudo ku i ka çuar fati e kudo po ndërtojnë fatin e tyre, do të rrahë në sheshin “Skënderbej”. “Në Tiranë, në Prishtinë, në Tetovë e kudo ku rreh zemra e shqiptarit, ne jemi bashkë në një thirrje e një besim: Liria ka emër! Liria ka emrin e çlirimtarëve të djeshëm dhe luftëtarëve të sotëm, që ndeshen për shumë më shumë se lirinë personale. Po ndeshen për të vërtetën, kujtesën historike dhe të drejtën e një populli që nuk ka marrë shpagim e as nuk kërkon hakmarrje, por do, lutet e kërkon të marrë e do të marrë, vetëm drejtësi. Në 17 tetor zemra e shqiptarëve anë e mbanë botës, kudo ku i ka çuar fati e kudo po ndërtojnë fatin e tyre, do të rrahë në sheshin “Skënderbej”. Nën hijen e Heroit

EPOKA E RE**Lirim GECI**

PRISHTINË, 15 TETOR - Protesta e së premtes në Tiranë, në mbështetje të liderëve të UÇK-së që janë duke u gjykuar në Hagë, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi, është duke marrë mbështetje mbarëshqiptare. Pas kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka dhënë mbështetje kësaj proteste. Osmani ka thënë se ka përkrahur secilën protestë që thërret për

drejtësi. “E mbështes këtë protestë. E kam mbështetur secilën protestë që thërret për drejtësi. Drejtësi që respekton parimet më të larta të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Krerët e UÇK pikërisht se kanë pasur besim në drejtësi janë paraqitur para saj, pa asnjë dyshim për drejtësinë”, ka thënë Osmani në një prononcim për medie. Osmani ka thënë se Kosova kërkon respektim të parimeve më të larta të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe se u jep të drejtë qytetarëve që kërkojnë respektim të këtyre standardeve.

Motoristët nisen nga Prekazi drejt Hagës në mbështetje të liderëve të UÇK-së

PRISHTINË, 15 TETOR - Nga Kompleksi Memorial "Adem Jashari" në Prekaz të mërkurën është bërë nisja e marshit simbolik me motoçikleta drejt Hagës, i organizuar nga platforma "Liria ka Emër, me qëllim për të shprehur mbështetje për drejtësinë dhe për liderët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që po gjykohe në Hagë. Organizatori i marshit, Ismail Tasholli, ka thënë se ky rrugëtim bart një mesazh të fortë simbolik dhe kombëtar. "Sot e kemi filluar

marshin. Synimi ynë është që karvanit t'u bashkohen pjesëtarë nga qytete të ndryshme të Kosovës dhe diasporës. Do të ndalemi në Cyrih dhe më pas në Dyseldorf, ndërsa më 19 tetor do të arrijmë në Hagë", ka thënë Tasholli. Ai ka thënë se nisja nga Prekazi nuk është e rastësishme, por mbart kuptimin historik të sakrificës dhe lirisë. "Prekazi është pikënisja e çdo shqiptarizmi. Mesazhi ynë është i qartë – 'Liria ka emër'. Kërkojmë drejtësi, transparencë dhe

gjykim të paanshëm, jo politik", u shpreh ai. Sipas tij, marshit do t'i bashkohen qindra motoristë nga vende të ndryshme të Evropës, përfshirë Italinë, Holandën, Greqinë dhe Zvicrën, ndërsa në Bruksel, pranë Parlamentit Evropian, do të dorëzohet një kërkesë për transparencë dhe monitorim të procesit gjyqësor në Hagë. "Nuk do të mbajmë fjalime gjatë rrugëtimit, për të mos e politizuar marshin dhe për të ruajtur karakterin e tij simbolik", ka thënë Tasholli.



Kombëtar, ne do të protestojmë kundër padrejtësisë që prek të gjithë shqiptarët, çojmë zërin tonë në Hagë duke kërkuar kthimin në liri të çlirimtarëve. Ajo që lindi si gjykatë speciale e parimeve të së drejtës nuk mund të jetë pafundësisht sinonim i padrejtësisë e turp i drejtësisë ndërkombëtare, që kërkon të përmbysë historinë, të relativizojë të vërtetën, të përdhosë sakrificën përmes padrejtësive procedurale, paraburgimit të zgjatur pa gjyq. E mbi të gjitha kur sot, ka vetëm një grusht akuzash të pabaza, të pafaktuara, pjellë e një raporti të diskretituar tanimë si prodhim fantazie nga hetimet serioze kombëtare dhe ndërkombëtare", ka thënë ajo, duke shtuar se "Shqipëria do të vazhdojë të jetë një zë i fortë dhe i pandashëm në përkrahje të Republikës së Kosovës, por edhe në denoncimin e kësaj padrejtësie, deri në kthimin në shtëpi të luftëtarëve". "Shqiptarët bashkë për Lirinë! Për Drejtësinë! Për Kosovën!", ka thënë ajo.

Balla: Mijëra zemra do të bashkohen në Tiranë për të kërkuar drejtësi për çlirimtarët

Edhe deputeti shqiptar nga radhët e Partisë Socialiste, Taulant Balla, ka dalë në përkrahje të protestës së 17 tetorit në Tiranë, e cila zhvillohet në mbështetje të kërësve të UÇK-së që po mbahen në Hagë. Ai në "Facebook" ka shkruar se në këtë protestë do të bashkohen mijëra zemra, duke filluar nga Kosova e në çdo cep të trojeve shqiptare. "Nga Kosova, Maqedonia e Veriut, Shqipëria, diaspora e çdo cep i trojeve shqiptare – mijëra zemra do të bashkohen këtë të premte, më 17 tetor, ora 17:00, për të kërkuar njëzëri drejtësi për çlirimtarët. Liria ka emër", ka shkruar Balla. Edhe tifogrupi "Dardanët" ka dalë në mbështetje të protestës gjithëkombëtare që do të mbahet më 17 tetor, në orën 17:00, në Tiranë, në mbështetje të ish-kërësve të UÇK-së që po gjykohe në Hagë. "Dardanët" kanë theksuar se protesta është një reagim i drejtë ndaj asaj që ata e kanë cilësuar si

padrejtësi ndaj luftëtarëve të lirisë, ndërsa kanë kërkuar drejtësi të vërtetë dhe jo, siç është thënë në reagim, barazi të rreme me kriminelët serbë. Në protestën që mbahet të premten në kryeqytetin shqiptar do të marrin pjesë edhe ish-presidenti i Shqipërisë, Alfred Mojsiu, kryeministri shqiptar Edi Rama dhe kreu i Bashkimit Demokratik për Integrim në Maqedoni të Veriut, Ali Ahmeti.



Agim Pllashniku niset në këmbë nga Prishtina drejt Tiranës për të protestuar në mbështetje të UÇK-së

Agim Pllashniku, veteran i UÇK-së, është nisur të mërkurën në orën 10:00 nga sheshi "Zahir Pajaziti" në Prishtinë, në këmbë drejt Tiranës, për të marrë pjesë në protestën që është parashikuar të premten, më 17 tetor, në orën 17:00 në sheshin "Skënderbej" të Tiranës. Ai ka thënë se këtë marshim është duke e bërë "në shenjë nderimi dhe mbështetjeje për luftën e drejt të UÇK-së" dhe protestës kundër "padrejtësive që po u bëhen drejtuesve të UÇK-së që po mbahen në Hagë".

UNË JAM UÇK PROTESTË GJITHËKOMBËTARE NË TIRANË

Për lirinë, për të ardhmen,
për drejtësinë!

MË 17 TETOR 2025

NË ORËN 17:00

SHESHI "SKËNDERBE" TIRANË

ORGANIZOHET NGA KATEGORITË
E DALA NGA LUFTA E UÇK-së

SHQIPTAR GUBETINI: LE TË JEMI BASHKË, KRAH PËR KRAH, MË 17 TETOR NË SHESHIN 'SKËNDERBEJ'

PRISHTINË, 15 TETOR - Thirrje për pjesëmarrje masive në protestën gjithëkombëtare në mbështetje të UÇK-së dhe drejtësi për liderët e saj në Hagë ka bërë edhe afaristi dhe drejtuesi politik i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Gjermani, Shqiptar Gubetini. Ai ka thënë se është koha të dëgjohet fuqishëm zëri i shqiptarëve për dinjitet kombëtar. "Edhe pak ditë na

ndajnë nga Protesta gjithëkombëtare në Tiranë! Koha është tani që zëri ynë të dëgjohet fuqishëm - për dinjitetin kombëtar, për të drejtat tona dhe për vlerat që i kemi mbrojtur me sakrificën shekullore. E premte, 17 tetor 2025, ora 17:00, sheshi 'Skënderbej' - Tiranë. Le të jemi bashkë, krah për krah, si dikur! Për lirinë, për të ardhmen, për drejtësinë!", ka

shkruar Gubetini në rrjetet sociale. Protesta në Tiranë pritet të jetë masive dhe një shprehje e unitetit kombëtar dhe e mbështetjes për vlerat e luftës së UÇK-së, si dhe një reagim ndaj padrejtësive që po u bëhen liderëve të UÇK-së në proceset gjyqësore në Hagë, përfshirë Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin, Rexhep Selimin, etj.

PROCESET E PAKOORDINUARA KOMBËTARE DHE KONSTRUKTET E KOORDINUARA ANTIKOMBËTARE



Milazim KRASNIQI

Proceset e pakoordinuara përshkrijnë gjithë historinë tonë të kombformimit, që nga përpjekja e Mahmut Pashë Bushatit për të formuar një shtet shqiptar, nga rivalitetet dhe madje konfliktet e armatosura ndërmjet Bushatlive e Ali Pashë Tepelenes, nga fërkimet në Lidhjen e Prizrenit e deri në ditët tona. Unë do të fokusoj vetëm disa nga episodet pas rënies së Murit të Berlinit, kur u krijuan realitete të reja e mundësi të reja të koordinimit brendakombëtar.

Koordinim i mbetur në tentativë

Kriza e ish-RSFJ nxiti në Kosovë e në viset e tjera shqiptare një lëvizje antikomuniste, demokratike, e cila aspironte bashkëngjitjen e shqiptarëve në sferën atlantike. LDK në Kosovë ishte bartësja kryesore e atij procesi. LDK ndikoi edhe të shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, në Luginën e Preshevës dhe në Malin e Zi. (Ibrahim Rugova, Nevzat Halili, Riza Halimi, Mehmet Bardhi, ishin liderët e rinj dhe të ardhur nga një proces koordinimi brendashqiptar.) Edhe pse autonomia e Kosovës u abrogua nga Serbia në vitin 1989 dhe Kosova ra në okupim klasik më 5 korrik 1990, lëvizja për demokraci e pavarësi vazhdoi të jetë aktive. Për të gjetur përgjigje për dilemat e reja që u shfaqën për fatet e shqiptarëve në ish Jugosllavi, u formua Këshilli Koordinues i Partive Politike Shqiptare në Jugosllavi, i cili miratoi dokumentin e rëndësishëm “Tri opcionet”, një shembull i rrallë i koordinimit të plotë ndër shqiptarë. Në atë dokument parashihej që të formohej Republika e Kosovës, nëse nuk ndryshonin kufijtë e brendshëm të RFSJ-së, Republika e Shqiptarëve në Jugosllavi, nëse ndryshonin kufijtë e brendshëm të republikave e krahinave ekzistuese, ose bashkimi me Shqipërinë, nëse ndryshonin kufijtë e jashtëm të federatës. Në rrethanat e okupimit dhe të luftës që kishte filluar në pjesën veriore të ish federatës jugosllave, ai koordinim ishte domethënë, sado që nuk kishte ndonjë ndikim konkret në zhvillimet që pasuan, në rend të parë për mungesë të komponentës ushtarake tek ne shqiptarët, pasi me eliminimin e autonomisë ishte eliminuar edhe Mbrojtja Teritoriale, një komponentë gjysmë ushtarake, e cila në luftën sllovene, i dha Sllovensië fitoren në konflikt me armatën jugosllave.

1. Lëvizja e dhjetorit 1990 në Shqipëri solli dinamikë të re në skenën kombëtare. Rënia e

stalinizmit shqiptar dha impulse për bashkëpunim ndërmjet shqiptarëve në realitetet e reja gjeokulturore e gjeopolitike, ku Perëndimi po merrte terren. Ndikimi i Kosovës në nxitjen e asaj lëvizjeje nuk është shumë i qartë, por me gjasë ka ekzistuar, e pakta në aspektin psikologjik e propagandistik. (Ibrahim Rugova më ka thënë privatisht, në vitin 1996, në kulmin e hidhërimit me Berishën, se Rugova ishte pyetur nga amerikanët dhe se e kishte dhënë “okejin” për Sali Berishën si lider i lëvizjes.) Fitorja e demokracisë në Shqipëri, solli më shumë kontakte, por jo edhe kooordinim të mirëfilltë.

2. Ngjarjet në ish Jugosllavi, sidomos agresioni serb në Slloveni e Kroaci, nxitu veprime të shpejta edhe në Kosovë, sikundër ishte referendumi për pavarësinë e Kosovës në shtator 1991. Referendumi ishte më shumë i koordinuar me veprimet që u bënë në Slloveni e në Kroaci, se sa me ndonjë koordinim brendashqiptar. Zgjedhjet parlamentare në mars të vitit 1992 në Shqipëri dhe zgjedhjet parlamentare e presidenciale në maj 1992 në Kosovë, e krijuan në realitet të ri, ku raportet Kosovë-Shqipëri duhej të shiheshin si raporte ndërshtetërore. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, në Luginën e Preshevës dhe në Malin e Zi, faktikisht u lanë në fatin e vet. U la mënjanë platforma e Këshillit Koordinues të Partive Shqiptare, ndoshta edhe nën ndikimin e raportit të Rober Badenterit, i cili në dhjetor në vitin 1991 konstatoi procesin e dezintegrimi të Jugosllavisë, por pa prekur kufijtë e republikave ekzistuese, gjë që nënkuptonte se shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, në Malin e Zi dhe në Serbi, do të mbteteshin brenda atyre republikave të pavarura.

3. Forcimi i pushtetit në Berishës në Tiranë filloi të reflektohej si sjellje paternaliste ndaj Kosovës e sidomos ndaj shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut. Pati një tentim për armatosje të shqiptarëve në R.M, i cili u zbulua e u kompromentua, duke sjellë pasojë në organizimin politik shqiptar. (Sipas rrëfimit të Mitat Eminit, udhëtimin e vullnetarëve shqiptarë e kanë mbuluar me kamera ushtarake të ushtrisë shqiptare, ndërsa ato material mandej kanë rënë në duart e autoriteteve maqedonase.) Atje u provokua pastaj fraksionimi i Partisë për Prosperitet Demokratik e prej saj doli Partia Demokratike Shqiptare e Arben Xhaferit, e cila në fillimet e saj ishte e afërt me Berishën, (më vonë u afrua me Partinë Socialiste.) Në vitin 1996 pati një tentativë nga Berisha edhe për detronizimin politik të Rugovës, me anën e Demaçit dhe të disa eksponentëve brenda LDK-së. Iniciativa me gjasë ishte në kundërshtim me sugjerimet amerikane, (u bë për të fshehur problemin e zgjedhjeve të vitit 1996, vjedhjen masive të votave) gjë që pati pasojë të rënda për Berishën e Shqipërinë, e cila praktikisht u dezintegrua si shtet në vitin 1997. Kësisoj, në vend të koordinimit, u eksperimentua

paternalizmi, destabilizimi dhe prishja e raporteve.

4. Koordinim brendakombëtar nuk pati as për luftën çlirimtare të viteve 1998-1999. E para, nuk pati koordinim brenda Kosovës, gjë që u tregua kobsjellëse për politikën në Kosovë, pas çlirimit. Por as në Shqipëri nuk pati koordinim të qartë lidhur me UÇK-në.

5. Proceset pas çlirimit të Kosovës morën tjetër drejtim. Prezenca civile e ushtarake ndërkombëtare në Kosovë, nuk lejoi më asnjë politikë që aspironte integrimin e bashkimin kombëtar. Partitë që proklamoni program të atillë, nuk fitonin as 1% në zgjedhje dhe u shuan. Pra, Kosova nën UNMIK-un dhe KFOR-in, e formësuar nga Plani i Ahtisarit, është shpall shtet multientik, krejt në kundërshtim me aspiratën e shqiptarëve për shtet kombëtar e bashkim kombëtar. I tërë drejtimi i lëvizjes kombëtare është deformuar. Kjo shihet tragjikisht në deklaratën e Albin Kurtit para disa vitesh, te varri i Skenderbeut në Lezhë, ku pati thënë se e kishte kuptuar që Kushtetuta e Kosovës nuk e lejonte bashkimin kombëtar!

6. Proceset kombëtare në Maqedoninë e Veriut, pas konflikti të vitit 2001 dhe Marrëveshjes së Ohrit, shkuan në drejtim të integritetit të shqiptarëve në atë shtet duke hequr dorë edhe nga projekti “Ilirida.” E njëjta gjë ka ndodhë edhe me shqiptarët në Malin e Zi dhe në Luginën e Preshevës. Pra, në demokraci e në liri është hequr dorë nga Projekti nacional, “Tri Opcionet” e vitit 1991 të KKPSHJ dhe nga programi klasik kombëtar. Sot jemi komb pa program kombëtar.

Gjendja shqiptare sot

- Shqipëria anëtare e NATO-s dhe shtet kandidat për në Bashkimin European. Por, edhe përkundër këtij procesi, Qeveria e Kosovës dhe qeveria e Shqipërisë janë të distancuara nga njëra-tjetra. Gjendja u bë acaruese sisomos pas disa tentativave të ndërhyrjeve naëve, si pjesëmarrja e LVV-së zgjedhjet në Shqipëri. Paradoksalisht, Qeveria e Kosovës ka marrërdhënie të mira me qeverinë nacionaliste të Maqedonisë së Veriut e deri diku edhe me Greqinë, por jo me qeverinë e Tiranës.

- Kosova është shtet i proklamuar i pavarur më 17 shkurt 2008, por ende është de jure protektorat ndërkombëtar, me prezencë ushtarake të KFOR-it, i cili e mirëmban konfliktin e ngrirë.

- Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut, me disa të drejta të dozuara, por pa asnjë qartësi për të ardhmen e tyre.

- Shqiptarët në Luginën e Preshevës janë në rrezik potencial ekzistencial, duke u shpërngulë e duke ua fshirë adresat. Nëse vazhdon kështu edhe disa vite, atje rrezikon të nbyllet ajo që ne e quajmë çështje shqiptare në Luginën e Pershecës ose Kosovën Lindore

- Shqiptarët në Malin e Zi janë pa ndonjë projekt, pa ndonjë lidhje në ndonjë program nacional, të

lënë të shijojnë triumfin e komunës së Tuzit dhe të numërojnë vendbabimet e shuara.

- Ndërsa shqiptarët në Greqi e në Turqi nuk kalkuloheh në ansjë lloj kombinimi.

- Sa u përket emigrantëve, ata përlllogariten me sasinë e remitencave që dërgojnë në vendet e origjinës.

Disa nga konstruktet antikombëtare sot

Konstrukte antishqiptare të ndryshme, nuk është e vështirë të lancohen brenda këtij realiteti shqiptar, ku mungon program kombëtar, ku mungon bashkëpunimi, mungon edhe vullneti për bashkëpunim. Pra, projektet antishqiptare janë edhe produkte të dobësive tona e jo vetëm i fuqisë a mençurisë së armiqve tanë.

1. Kosrukti më virulent në këto vite ka qenë dhe mbetet “Lëvizja e Deçanit”, e cila kërkon konvertimin e shqiptarëve të Kosovës në të krishterë, pothuajse me formulën e Rekonkuistës spanjolle të shekullit XV. Lidhja e emërtimit me Deçanin, në fakt ka të bëjë me lidhjen me manastirin e Deçanit dhe thirrja për kalim në katolicizëm, sipas një dokumenti kroat, shihet vetëm si fazë kalimtare për kalim në ortodoksinë serbe. Ideja e “Lëvizjes së Deçanit” është proserbe, antikombëtare, antikulturore. Synimi i saj është formimi i një minishteti serb rreth manastirit të Deçanit e kthimi i selinë së Patriarkanës Serbe në Pejë. Formimi i atij minishteti do ta ndante Kosovën dhe do ta rilegjitimonte influencën serbe.

2. “Kombi Kosovar” është një kontrukt tjetër ideologjik e propagandistik, i cili dëgjohet herë pas herësh, por gjithnjë më i ngjirur. Regjistrimi i popullsisë i vitit 2024 ka dhënë rezulatin, ku shumica absolute e popullsisë janë thjesht shqiptarë.

3. “Shteti bektashi” është një konstrukt tjetër ideologjik e propagandistik, i lancuar por pa asnjë mbështetje as në traditat fetare bektashiane shqiptare as në realitetin politik e kombëtar shqiptar. Ideologu i bektashizmit, Naim Frashëri, në “Fletore e bektashijet” shprehet kështu: “ : “Bashkë me plegësinë e me parësinë të bëjnë dashurin’ e vëllazërinë edhe njësin’ e miqësinë në mes të të gjithë shqiptarëve, të mos ndahen njeri nga tjetri, të Krishter e Myslimanë të jenë tok, pa të venë gjithë punët mbroth e mbarë, të mos shahenetë sot Shqiptari, që ka qenë i lëvdur në gjithë botë gjithnjë.” Ndërsa ideologu i kombformimit shqiptar, Sami Frashëri në veprën “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e çdo të bëhet”, shkruan: “edhe nga besa (feja-sqarim imi) Shqiptarët ndahen në myslymanë, që janë dy të tret e më të krishterë, që janë një e treta. Të krishtenët ndahen afro përgjysmë më katolikë Llatinë, si i themi, edhe më orthodoxë. Në Gegëri krishtenët janë katolikë,

në Toskëri orthodoxë. Edhe myslimantë janë në ndarë në synij e Bektashinj. Po këto ndarje të besës nuk sjellin nonjë ç’qim (dallim) e çarje në mes të Shqiptarëve.” Samiu më tutje argumenton: “Shqipëtar i mysliman qoftë, orthodox qoftë, katolik qoftë ëshët gjithnjë shqiptërar. Besa (feja, sqarim imi) nuk sjellë kurrë ndarje e çarje në mest të tyre.”

Nëse këto ndarje fetare nuk sillnin dallime në fundin e shekullit XIX, kur ishte hapur çështja e formimit të kombit, si është e mundur që ato dallime në shekullin XXI të provokohen e të acarohen deri në idenë e formimit të një shteti brenda shtetit shqiptar, goja për të mbrojtur bektashijtë shqiptarë? Prej kujt u dashka të mbrohen bektashijtë, kur absolutisht nuk i diferencon dhe nuk i provokon askush?

4. Plani Franko-Gjerman dhe Aneksi i Ohrit kanë ngjashmëri me Protokollin e Korfuzit të vitit 1914, sepse krijojnë autonomi të serbëve dhe e federalizojnë Kosovën. me Planin Franko-Gjerman dhe me planin e zbatimit, serbët kanë fituar autonominë territoriale (me Asociacionin), autonominë kulturore (arsim e kulturë të lidhur direkt me Serbinë), autonominë funksionale (me Kishën në qendër) dhe autonominë personale me vetë-menaxhimin në qendër. (Paraprakisht ishte ideja e shkëmbimit të territoreve ndërmjet Serbisë e Kosovës, një projekt i hartuar nga Instituti “Lindje Perëndim” të idejuar e drejtuar nga ish ambasadori amerikan në Beograd, Kameron Manteri e të pëlqyer nga ish sekretari amerikan për siguri, Xhon Bolltoni.)

Konkludim

Tërësinë e kombit shqiptar, kështu si është, i pakooordinuar e pa asnjë program kombëtar, e mban në këmbë vetëm përkatësia jonë në hapësirën gjeokulturore e gjeopolitike atlantike, e jo ndonjë projekt shqiptar. Në rast se do të ndodhte ndonjë ndryshim, që do të sillte dobësimin e ombrellës atlantike, shqiptarët do të ktheheshim në ciklin e njohur të tragjedive që nga Kongresi i Vjenës (1815), i cili krijoi ambientin për shkatërimin e pashallëqeve shqiptare, Kongresi i Berlinit(1878) , i cili legalizoi spastrimin etnik dhe aneksimin e territoreve shqiptare, Konferenca e Londrës (1913), e cila zyrtarizoi copëtimin e territoreve shqiptare dhe gjenocidin e luftërave ballkanike, Konferenca e Jaltës (1945) , e cila i la hapësirat shqiptare nën sundimin sllavo-komunist. Pra bindja ime është se ende jemi jo vetëm komb i parehabilituar nga tragjeditë e nga traumat, po edhe komb i rrezikuar, në rast se prishet dominanca e tashme atlantike. (27 shtator 2025, Tiranë)

DRONË NË QIELL, TENSION NË TOKË

PRISHTINË, 15 TETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, është duke u përballur me protesta antiqeveritare në Beograd, ndërsa në Prishtinë formimi i institucioneve të reja zhargitet prej muajsh. Por, përtej krizave të brendshme në të dyja vendet, retorika për sigurinë po bëhet gjithnjë e më e ashpër, duke ngritur pyetje për rrezikun real dhe përfituesit e mundshëm.

Javën e kaluar presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur komandantin e misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR, Ozkan Ulutash, për të diskutuar, siç ka thënë, kërcënimet nga dronët serbë.

Si komandante supreme e Forcës së Sigurisë së Kosovës, Osmani ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit me KFOR-in për të parandaluar çdo veprim destabilizues nga Serbia.

Në fund të muajit të kaluar zyrtarët e Kosovës kanë raportuar se hapësira ajrore e vendit ishte shkelur nga dronë të dyshuar serbë, por nuk kanë dhënë detaje për kohën apo rrethanat e incidentit.

KFOR-i, megjithatë, ka thënë se nuk ka vërejtur ndonjë hyrje të dronëve nga jashtë që kërcënonte sigurinë.

Po ato ditë Policia e Kosovës ka thënë se ka arrestuar një shtetas të Serbisë që i ka sulmuar zyrtarët policorë në pikën kufitare të Jarinjës.

Osmani e ka ngritur çështjen e kërcënimeve nga Serbia edhe në Kopenhagë, ku ka marrë pjesë në samitin e Komunitetit Politik Evropian më 2 tetor. “Serbia i trajton shtetet fqinje si shtete që nuk ekzistojnë, si shtete ndaj të cilave vepron me agresion. Është kopje e metodave të Rusisë”, ka thënë ajo.

Duke iu përgjigjur Osmanit, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ka thënë se “të gjithë po përgatiten për luftë” dhe e ka akuzuar Kosovën se po shfrytëzon këtë kohë, për të fituar mbështetje ndërkombëtare. “Ne duam ta shmangim luftën. T’i shmangim konfliktet. Druaj se askush nuk do të dëgjojë më askënd, dhe të gjithë - vërtet dhe seriozisht - po përgatiten për luftë”, ka thënë Vuçiqi.

Ai nuk ka ofruar prova për pretendimet e tij, dhe ekspertët e sigurisë në Beograd i kanë parë ato si propagandë për përdorim të brendshëm. “Gjatë vitit të fundit, gjithçka në Serbi, përfshirë edhe politikën e jashtme, i nënshtrohet dinamikës së protestave antiqeveritare. E vetmja gjë me të cilën merret shteti, është mbijetesa e regjimit. Në këtë kontekst, ai vazhdimisht përpiket të bëjë teatër dhe të

gjejë një armik të huaj për ta zhvendosur vëmendjen qoftë edhe për kohë të shkurtër nga protestat”, ka thënë Vuk Vuksanoviq nga Qendra e Beogradit për Politika të Sigurisë, për “të Radios Evropa e Lirë”.

Vuçiqi edhe javën e kaluar ka reaguar me ashpërsi ndaj lajmit se Kosova ka pranuar dronë nga Turqia, duke u shprehur “i tmerruar” me, siç ka thënë, sjelljen e Ankarasë.

Shefi i shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë së Serbisë, Millan Mojsiloviq, ka thënë se ka zhvilluar një bisedë urgjente me komandantin e KFOR-it, Ozkan Ulutash, të cilit i ka shprehur shqetësimin se armatosja e Kosovës mund të ndikojë në stabilitetin e rajonit. Për Igor Tabakun, analist ushtarak në portalin “Mbrojtja dhe Siguria” nga Zagrebi, këto janë gjepura të një regjimi që kërkon ta shpërqendrojë publikun. Ai ka theksuar se çdo përshkallëzim i mundshëm në rajon do të kishte pasojë serioze për NATO-n, pasi shumica e vendeve përreth Serbisë janë anëtare të aleancës ose bashkëpunojnë ngushtë me të. Por, ai ka shtuar se shumëçka do të varet edhe nga mënyra se si udhëheqja serbe menaxhon tensionet e brendshme. “Nëse tensionet e brendshme në Serbi vazhdojnë të rriten, nuk do të më befasonte nëse regjimi do të përpiquej ta zhvendoste vëmendjen publike të një armik i jashtëm. Kjo është shumë më e përshtatshme për pushtetin sesa të flasë për përdorimin e gazit lotsjellës nga policia apo për nxjerrjen e tankeve në rrugë”, ka thënë Tabak për “REL”-in..

Dhe Kosova është një prej pikave më të cënueshme, sipas tij, marrë parasysh historinë e konfliktit.

Muajin e kaluar janë bërë saktësisht dy vjet prej se një grup serbësh kishte sulmuar Policinë e Kosovës në Banjaskë, duke vrarë një polic. Kosova ka bërë përgjegjëse Serbinë për incidentin, por Beogradi e ka mohuar përfshirjen.

Tabak nuk e ka përjashtuar mundësinë që një “formë e tillë e terrorizmit” të përsëritet. “Për këtë nuk nevojiten as shumë njerëz e as shumë pajisje. Një aksion i tillë mund të organizohet pa lëvizje të mëdha shtetërore dhe pa logjistikë të ndërlikuar. Fatkeqësisht, skenarë të tillë janë të mundshëm, por, për fat të mirë, ndikimi i tyre është më i kufizuar, sepse përfshijnë më pak mjete dhe njerëz”, ka thënë ai.

“Radio Evropa e Lirë” për disa ditë ka tentuar të kontaktojë ministrin në detyrë të Punëve



të Brendshme të Kosovës, Xhelal Sveçla, dhe drejtorin e përgjithshëm të Policisë, Gazmend Hoxha, për të biseduar mbi situatën e sigurisë në vend dhe vlerësimin e rrezikut nga Serbia, por asnjëri prej tyre nuk ishte i qasshëm.

Ish-komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kadri Kastrati, ka thënë se situata në Kosovë është e qetë vetëm në sipërfaqe, pasi Serbia, që nga Banjaska e këndeje, po zhvillon një luftë hibride kundër vendit. Ai ka përmendur sulmin në Ibër-Lepenc dhe përdorimin e dronëve si shembuj të kësaj strategjie. Po ashtu thotë se ka informacion se në Kosovë ndodhen rreth 1.300 deri në 1.600 serbë besnikë të Vuçiqit, të gatshëm për të zbatuar urdhrat e tij. “Të gjithë këta janë të trajnuar dhe të stërvitur mirë në bazat ushtarake dhe të xhandarmërisë (serbe) përreth Kosovës dhe jetojnë e veprojnë brenda Kosovës. Kryejnë punë të rëndomta. Në momentin që marrin ndonjë sinjal që duhet të mobilizohen, e dinë saktë vendin se ku duhet të lajmërohen. Dhe ky është një rrezik potencial që unë e konsideroj në të ardhmen”, ka thënë Kastrati.

Ai ka theksuar se institucionet e Kosovës janë të informuara për ekzistencën e këtyre grupeve në veri. Kastrati ka shtuar se, ndonëse nuk njihen me emra të përveçëm, dihet numri i tyre dhe fakti që posedojnë armë të fshehura në zona malore.

Në vitin 2023, Qeveria e Kosovës ka shpallur organizata terroriste dy grupe serbësh që veprojnë në veri - “Brigada e Veriut” dhe “Mbrojtja Civile” - duke argumentuar se pjesëtarët e tyre ishin të përfshirë në sulme ndaj Policisë së Kosovës.

Policia e Kosovës, herë pas here, njofton për konfiskimin e armëve dhe municioneve në këtë pjesë të vendit. Në njërën prej aksioneve më të fundit, në mes të shtatorit, ministri në detyrë i Punëve të Brendshme,

Xhelal Sveçla, ka thënë se policia ka gjetur municion dhe pajisje ushtarake në pronën e njërit prej dhjetëra të akuzuarve për sulmin në Banjaskë.

As Vuksanoviq nuk e sheh të mundshëm një sulm konvencional të Serbisë kundër Kosovës, për shkak të pranisë së NATO-s. Por, vlerëson se udhëheqësit e të dyja vendeve, të përballur me kriza të brendshme, mund të nxisin provokime për të zhvendosur vëmendjen publike. “Nuk do ta përjashtoja 100 për qind mundësinë e një dhune të lokalizuar në veri të Kosovës. Këtu janë dy lojtarë të rëndësishëm. Nga njëra anë është kryeministri në detyrë i Kosovës (Albin) Kurti, i cili gjithashtu gjendet në një pozitë të paqartë, për shkak të mosformimit të Qeverisë së re. Në përpjekje për të shpëtuar veten, mund të marrë ndonjë vendim që trazon veriun. Në anën tjetër, kemi Vuçiqin që gjendet në një krizë edhe më serioze se Kurti dhe mund të pretendojë se (serbët) po kërcënohen, për shembull...”, ka thënë Vuksanoviq.

Por, sa e përgatitur është Kosova të përballlet me një valë të mundshme dhune? Në ditën kur ka pranuar mijëra dronë kamikazë nga Turqia, kryeministri në detyrë, Kurti, ka përmendur edhe disa prej blerjeve të mëparshme, përfshirë kamionët ushtarakë, “Rheinmetall”.

“Kjo tregon se ushtria jonë po forcohet gjithnjë e më shumë dhe se po pajiset me armatim modern”, ka thënë Kurti më 8 tetor.

Muajin e kaluar, Forca e Sigurisë së Kosovës, që është në proces të transformimit në ushtri, pranoi edhe disa dronë të blerë nga ShBA-ja, ndërsa vendi vazhdon pagesën për sistemet kundërajrore “Javelin”, gjithashtu të furnizuara nga ShBA-ja.

Përgjegjësia për hapësirën e ulët ajrore të Kosovës mbetet te KFOR-i, ndërsa të lartën e

mbikëqyr Hungaria. KFOR-i është përgjegjës edhe për sigurinë e kufijve tokësorë të Kosovës me Serbinë, ndërsa për pjesën tjetër të vijës kufitare është Policia e Kosovës. KFOR-i vazhdimisht nënvizon se garanton një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur. Sipas ish-komandantit Kadri Kastrati, misioni i NATO-s është çelësi i stabilitetit në Kosovë, porse buxheti i mbrojtjes duhet të rritet për të përballuar sfidat e ardhshme. “Qeveria në ardhje, kushdo që ta formojë, do të duhej ta kishte një prej prioriteteve kryesore mbrojtjen dhe sigurinë. ShBA-ja dhe NATO-ja në përgjithësi kanë përcaktuar pragun prej 5 për qind të bruto prodhimit vendor për mbrojtje dhe siguri, për shkak të situatës globale. Ne jemi diku te 1.8 për qind e bruto prodhimit vendor. Minimalisht do të duhej ta kishim 5 për qind”, ka thënë Kastrati.

Përveç në FSK, ai ka thënë se duhet investuar edhe te Policia e Kosovës, e cila aktualisht ka rreth 10.000 pjesëtarë. “Do të duhej të rritej numri i tyre dhe t’u rritej edhe kalibri i armatimit. Forcat e kufirit duhet të jenë të përgatitura siç janë forcat për ndërhyrje të shpejtë të Polcisë së Kosovës”, ka thënë Kastrati.

Të kontaktuar nga “Radio Evropa e Lirë”, zyrtarë të Ministrisë së Mbrojtjes së Kosovës nuk kanë zbuluar se sa ka shpenzuar Kosova këtë vit për armatim.

Por, në një deklaratë dhënë “Radios Evropa e Lirë” në fund të vitit të kaluar, ministri tani në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka thënë se, në katër vjet, Kosova ka shpenzuar mbi 269 milionë euro për blerje të armatimit. E, sipas Institutit Ndërkombëtar të Kërkimeve për Paqen në Stokholm (SIPRI), Kosova në vitin 2024 ka ndarë rreth 162 milionë dollarë për mbrojtjen, ndërsa Serbia rreth 2.2 miliardë.

LANSOHET SISTEMI DIGJITAL I INSPEKTIMEVE TË PUNËS NË KOSOVË

PRISHTINË, 15 TETOR - Inspektorati Qendror i Punës ka lansuar sistemin digjital të inspektimeve të punës në Kosovë, duke përfshirë dorëzimin e pajisjeve dhe trajnimin praktik për inspektorët mbi përdorimin e këtij sistemi. Me këtë rast, ambasadori i Suedisë në Kosovë, Jonas Westerlund, ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndikimin e këtij projekti në përmirësimin e kushteve të punës. “Kosova po i afrohet anëtarësimit në BE. Po ashtu, e keni avancuar punën e inspektimit të punës. Pra, këtu është një shembull më i qartë se si bashkëpunimi ndërkombëtar ndikon. Po ashtu, dua ta lavdëroj për lansimin digjital të inspektimeve sepse kjo dëshmon një profesionalizëm dhe një punë efektive. Masa të tilla mund ta rrisin mbikëqyrjen dhe t’i mbrojnë punëtorët. Kjo iniciativë është e Kosovës për ta nxitur efikasitetin dhe punën. Siç e dini, këtë vit kemi pasur një numër të fataliteteve të personave në vendin e punës, prandaj kemi nevojë të vazhdojmë ta përmirësojmë punën tuaj. Shembulli suedez

tregon se kombinimi i formave dhe shfrytëzimi i mjeteve digjitale rrisin standardet e vendit të punës dhe jemi mirënjohës që kemi një bashkëpunim kaq të mirë”, ka thënë ambasadori Westerlund. Ndërsa ushtruesi i detyrës së drejtorit të Zyrës së Inspektoratit të Përgjithshëm, Lum Vranica, ka thënë se sistemi i ri digjital është një hap drejt modernizimit dhe transparencës. “Ky është një hap i madh drejt modernizimit dhe efikasitetit se si ligji funksionon në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve. Në kuadër të kësaj reforme të gjithanshme, qëllimi është i qartë: më shumë transparencë dhe efikasitet për qytetarët dhe më pak burokraci. Ky është vetëm fillimi i një transformimi të thellë. Dua t’i falënderoj inspektorët për punën dhe angazhimin e tyre si dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Bashkë po ndërtojmë një sistem inspektimesh që u shërben qytetarëve tanë”, ka thënë Vranica. Ndërsa ushtruesi i detyrës së drejtorit të Inspektoratit të Punës, Rizal Plakolli, ka vlerësuar se ky sistem është më

shumë se një risi teknologjike. “Ky sistem përfaqëson më shumë se një risi të teknologjisë. Ky është një hap drejt modernizimit të inspektimit të punës. Falë këtij sistemi do të krijohet një proces më efikas dhe i lidhur ngushtë me institucionet e tjera. Një element i rëndësishëm është se ky sistem është i lidhur me Administratën Tatimore të Kosovës. Kjo tregon se për herë të parë Inspektorati i Punës do të ketë një pamje më të integruar. Krahas këtij sistemi, dua të theksoj disa hapa të rëndësishëm: së pari, jemi në proces të rekrutimit të 50 inspektorëve të rinj, kjo është një rritje e kapaciteteve tona dhe mundësi për reagime më të shpejta ndaj shkeljeve të të drejtave të punëtorëve. E dyta, është miratuar rregullorja që parasheh ndarjen në inspektorë të sigurisë dhe të marrëdhënieve të punës, të cilët do të punojnë në fusha të veçanta. E treta, sistemi digjital që po e implementojmë do të lehtësojë dhe shpejtojë ndjeshëm punën tonë. Në këtë kuadër më lejoni të shpreh një mirënjohje të thellë ndaj Ambasadës Suedeze për mbështetjen ndaj Inspektoratit të



Punës, ka thënë Plakolli. Më tutje, zyrtari i programit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për Kosovë, Blerim Murtezi, ka theksuar se ky projekt është rezultat i bashkëpunimit mes institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Kurse drejtoresha e Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Lumniye Ajdini, ka thënë se gjithmonë kanë qenë zëri përfaqësues i punëdhënësve në Kosovë. “Digjitalizimi i inspektimeve është një hap drejt ndërtimit të besimit ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat. Me këtë sistem të ri krijohet mundësia për një

proces më të drejtë, më të shpejtë dhe më të paanshëm, ku çdo palë qoftë inspektori, punëdhënësi apo punëtori, ka qasje të barabartë në informacione dhe në transparencë. Ky projekt, i mbështetur nga Qeveria e Suedisë dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës, është dëshmi e vlerës së bashkëpunimit ndërkombëtar dhe institucional. Si AKB ne besojmë se vetëm përmes partneritetit të sinqertë midis qeverisë, punëdhënësve dhe punëtorëve mund të ndërtojmë një treg pune të qëndrueshëm, të drejtë dhe të formalizuar”, ka thënë Ajdini.

AZEMI: KËTË VIT 26 PUNËTORË KANË VDEKUR NË VENDIN E PUNËS

PRISHTINË, 15 SHTATOR - Deri në muajin tetor të këtij viti, sipas Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, 26 punëtorë kanë gjetur vdekjen në vendin e punës, por të dhëna të tjera kanë në Inspektoratin e Punës. Sipas tyre, brenda kësaj periudhe kohore 13 punëtorë kanë vdekur në vend të punës, ndërsa kanë ndodhur 412 aksidente. Këto të dhëna janë bërë me dije në Konferencën e 11-të Ndërkombëtare me temën “Siguria në punë dhe në transport - qasje e integruara për zhvillim të qëndrueshëm dhe për mbrojtjen e jetës” të organizuar nga Kolegji “Tempulli”, AMRKS-ja dhe Instituti për Siguri Rrugore dhe Hulumtime në Transport.



Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve të Sektorit Privat, Jusuf Azemi, ka deklaruar se qeveritë e deritanishme nuk kanë bërë asgjë për sigurinë e punëtorëve në sektorin privat. Azemi ka theksuar se deri në këtë periudhë të vitit 2025, 26 punëtorë e kanë gjetur vdekjen

në vendin e punës. “Shifrat janë të tmerrshme. Ne kemi biseduar edhe për raportet pse tek inspektorati del 8 punëtorë e tek ne tjetër në vitin 2025 kemi 26 raste të vdekjeve në punë. Ne konsiderojmë se në momentin kur një punëtor nis të shkojë në punë dhe prej punës shkon në

shtëpi, ne e konsiderojmë se është në orar të punës dhe Inspektorati i Punës, nëse një punëtor sot lëndohet në pallat dhe nuk vdes dhe vdes në QKUK, këta nuk e konsiderojnë si rast i vdekjes”, ka thënë ai. Ndërsa udhëheqësi i divizionit ligjor pranë Inspektoratit Qendror të Punës, Arton Çerkini, ka thënë se, sipas të dhënave të tyre, deri në këtë periudhë të vitit 2025 kanë vdekur 13 punëtorë në vendin e punës, ndërsa kanë ndodhur 412 aksidente në punë, prej tyre 305 janë të rënda. Ai ka thënë se tashmë 32 inspektorë janë kategorizuar për sigurinë dhe shëndetin në punë. Sipas tij, sektori i ndërtimtarisë, prodhimtarisë dhe përpunimit

janë punët me rrezikshmërinë më të lartë në vend. Në anën tjetër, drejtori i Kolegjit “Tempulli”, Mehmet Krasniqi, ka thënë se siguria në vendin e punës dhe në rrugë nuk është luks, por nevojë jetike. Ai ka shtuar se shumë punëtorë në Kosovë punojnë pa mbrojtje të mjaftueshme dhe pa trajnime adekuate. Më tutje, shefi i kabinetit i ushtruesit të detyrës së ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Berat Ganiqi, ka thënë se përmirësimi i sigurisë rrugore vazhdon të jetë sfidë e madhe. Referuar të dhënave të Inspektoratit të Punës gjatë vitit 2024, kanë ndodhur shtatë vdekje në vendin e punës.

Bie numri i lindjeve në gusht 2025 krahasuar me muajin korrik

PRISHTINË, 15 TETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka bërë me dije se në muajin gusht 2025 janë regjistruar 2 516 lindje (brenda dhe jashtë Kosovës). Prej këtyre lindjeve të regjistruara, 1 284 lindje janë meshkuj dhe 1 232 lindje janë femra. ASK-ja ka theksuar se në muajin gusht 2025 ka rënie të numrit të lindjeve me rreth 6.4 për qind krahasuar me muajin korrik

2025. Sipas të dhënave të fundit të Bankës Botërore për vitin 2024, Kosova renditet e para në botë për nga shkalla e tkurrjes së popullsisë, me një rënie prej -9.7-përqindësh. Ky rezultat e vendos Kosovën në krye të listës së vendeve me rënien më të madhe demografike në nivel global, një shifër që ekspertët e cilësojnë si alarmante për të ardhmen e zhvillimit social

dhe ekonomik të vendit. Ndërkohë që popullsia botërore ka shënuar rritje mesatare prej një përqindësh, Kosova po përballet me trendin e kundërt, kryesisht për shkak të emigrimit masiv drejt vendeve evropiane, në kërkim të mundësive më të mira jetese dhe punësimi. Pavarësisht prej përpjekjeve të institucioneve për ta frenuar largimin e qytetarëve

dhe për ta nxitur rritjen e popullsisë përmes subvencioneve dhe politikave stimuluese, të dhënat tregojnë se vendi po përballet me një krizë demografike të thellë. ASK-ja ka publikuar edhe statistikën e vdekjeve. Gjatë muajit gusht 2025 janë regjistruar gjithsej 914 raste të vdekjeve (brenda dhe jashtë Kosovës). Nga gjithsej vdekje



të regjistruara, 515 janë meshkuj dhe 399 janë femra. Krahasuar me muajin korrik 2025, në muajin gusht janë regjistruar 4.3 për qind më shumë raste të vdekjeve.

SA REALIST ËSHTË ÇARMATIMI I HAMASIT?



Shumë shtete duan që Hamasi palestinez të çarmatoset. Por kjo për shumë arsye mund të jetë e vështirë. Është gjithashtu e diskutueshme, se kush do të kujdeset në të ardhmen për sigurinë në Rripin e Gazës. Si do bëhet më tej me Hamasin? Sipas planit të presidentit të SHBA-së, Donald Trump, milicët në Rripin palestinez të Gazës duhet të çarmatosen tërësisht. Por kjo ende nuk është arritur. Sipas medieve izraelite, si Jerusalem Post, organizata militante-islamike zhvillon luftime të dhunshme kundër grupeve rivalizuese. Si pasojë janë vrarë të paktën 32 vetë. Në rrjetet sociale qarkullojnë video, që tregojnë, se si Hamasi ekzekuton ose torturon të pandehur si kolaboratorë me Izraelin. Grupi i Hamasit klasifikohet në Gjermani, në Bashkimin Europian, në SHBA dhe në shtete të tjera si organizatë terroriste. Nëse do të arrihet të çarmatoset Hamasi, kjo ndërkohë është e pasigurtë. Presidenti i SHBA-së Trump u shpreh në mënyrë kontradiktore. "Praktikisht i gjithë rajoni e ka miratuar planin për çmilitarizimin e menjëhershëm të Gazës, për çarmatimin e Hamasit dhe që siguria e Izraelit të mos kërcënohet më në asnjë mënyrë", tha ai në fjalimin e tij para Knesetit, Parlamentit të Izraelit. Gjatë fluturimit drejt Izraelit Trump deklaroi, se

qeveria e tij ia ka lejuar Hamasit që përkohësisht të armatoset sërish. Hamasi përpiket pas muajve të luftës të rivendosë rendin.

"Një mesazh i qartë"

Që Hamasi pak pas tërheqjes së pranisë izraelite po tregon prezencë dhe po dërgon forca të armatosura në qytetin e Gazës, është një mesazh i qartë, thotë Simon Wolfgang Fuchs, islamolog në Universitetin Hebraik në Jerezualet. "Hamasi qartazi po jep një shenjë, se nuk është zhdukur nga Rripi i Gazës, kjo organizatë pretendon sërish të luajë rol atje." Deri në çarmatimin e Hamasit do të jetë një rrugë e gjatë, lë të kuptohet analiza e Think Tank Atlantic Council në SHBA. Për aq kohë sa Hamasi vazhdon të ekzistojë, qoftë si grup i armatosur apo si lëvizje politike -, ekziston një rrezik i madh, që ai të fitojë sërish influencën në Rripin e Gazës, për të realizuar interesat e veta, thuhet në këtë analizë. E pikërisht kjo duket se po ndodh tani.

Armët si garanci ekzistence

Hamasi faktikisht armatimin e vet e konsideron si garanci për ekzistencën, e kjo ushtarakisht, politikisht e po ashtu edhe në

mënyrë simbolike, thotë Simon Engelkes, drejtor i zyrës së fondacionit gjerman Konrad-Adenauer në Ramallah. "Pa një kompensim konkret politik, me gjasë Hamasi nuk do ta miratojë çarmatimin. 'Garancitë e sigurisë' të presidentit të SHBA-së Trump, se nuk do të vazhdojë lufta në Rripin e Gazës si rrjedhojë e marrëveshjes së armëpushimit, në këtë moment janë të pamjaftueshme." Edhe pse strukturat ushtarake të Hamasit në valën e luftës mundën të dobësohen ndjeshëm, rrjetet e kësaj organizate si dhe prania e dukshme në Gazë kanë mbetur funksionuese. "Kjo siguron afatshkurtër dhe afatmesëm aftësinë e saj për mbijetesë politike."

Kush mban përgjegjësi për sigurinë në Rripin e Gazës?

Çarmatimi i plotë i Hamasit mund të jetë i vështirë edhe sepse deri më 7 tetor 2023, dita e sulmit ndaj Izraelit, siguria e Rripit të Gazës ishte në duart e Hamasit. Pasi Hamasi më 2007 mori qeverinë në këtë territor, kjo organizatë ishte përgjegjëse për policinë dhe sigurinë e brendshme si dhe për drejtësinë. E paqartë është, se kush do t'i organizojë në të ardhmen këto detyra. Egjipti dhe Jordania

komunikuan, se ndërkohë janë duke përgatitur angazhimin për të ardhmen të rreth 5000 forcave të rendit sipas planeve aktuale. Por në këto struktura duhet të përfshihen edhe autoritetet policore të administratës autonome palestineze. Pikërisht ky mund të jetë edhe problemi, thotë islamologu Fuchs. "Eshtë shumë e mundshme që Izraeli të vendosë veton kundër këtyre forcave lokale." Sepse qeveria në Jeruzalem nuk do që të lejojë autoritetet e administratës autonome palestineze të kenë ndonjë rol në Gazë. Qeveria e Izraelit synon, që të mos lejojë asnjë forcë të tillë të ketë lidhje me qeverinë në Ramallah. "Ndaj është krejt e paqartë, se si do të bihet dakord lidhur me këtë çështje dhe në cilat duar do të kalojnë shërbimet përkatëse të sigurisë."

Paralajmërim nga kërcënim i mëtejshëm

Sipas kërkesës së shumë shteteve nuk duhet të jetë Hamasi përgjegjës për sigurinë. Presidenti i Francës Emmanuel Macron paralajmëroi nga një kërcënim i vazhdueshëm prej milicëve të Hamasit. "Një grup terrorist me mijëra luftëtarë, tunele dhe armatime të tilla nuk mund të shkatërrohet brenda natës", tha Macron pas nënshkrimit të marrëveshjes së

armëpushimit në Sharm El Sheikh të Egjiptit. Edhe kryeministri britanik Keir Starmer deklaroi, se vendi i tij është i gatshëm të ndihmojë në çarmatimin e Hamasit. Qeveria gjermane është kundër një pranie të mëtejshme politike të Hamasit. Ndaj pritet këtej e tutje përballja e vërtetë, thotë Simon Engelkes. "Kjo ka të bëjë jo vetëm me çështjen e armëve, por edhe me kontrollin politik dhe legjitimitetin: Kush do të flasë në të ardhmen për Gazën dhe me çfarë autoriteti?"

Rreziqe të mundshme edhe në Europë

Anashkalimi i interesave të Hamasit mund të jetë me risk, tërhoqi vëmendjen në Bundestag presidenti i Shërbimit Federal Informativ (BND) Martin Jäger: Nëse Hamasi nuk do të përfshihet në administratën e tranzicionit në Gazë, ose do të dëbohet nga Gaza, ka "rrezik shumë real", që ai të bëhet aktiv jashtë Gazës. "Kjo natyrisht do të prekte hapësirën arabe, por me siguri edhe të gjithë Europën." Afatgjatë, sipas vëzhguesve, gjithçka do të varet nëse palestinezëve do t'u mundësohet një jetë në dinjitet. Nëse kjo nuk ndodh, dhuna mund të shpërthejë dikur sërish.(DW)

NJË LUFTË TJETËR E MADHE NË SFOND



Më shumë se 12 civilë janë vrarë në Afganistan, teksa përleshje të reja kanë shpërthyer mes forcave të Afganistanit dhe Pakistanit më 15 tetor, thanë talibanët, duke shkelur paqen e brishtë që ishte në fuqi për pak kohë pas përplasjeve gjatë fundjavës që lanë të vdekur dhjetëra persona. Dikur aleatë, tensionet e fundit mes dy shteteve të Azisë Jugore shpërthyen pasi Islamabadi kërkoi nga udhëheqja talibane në Afganistan që të ndërmarrë hapa kundër militantëve që kanë intensifikuar sulmet me Pakistan, duke argumentuar se ata operojnë nga Afganistani.

Talibanët mohojnë se në Afganistan ka prani të militantëve pakistanezë. “Mëngjesin e sotëm, forcat pakistaneze nisën sulme... më shumë se 12 civilë u vranë dhe mbi 100 të tjerë u plagosën”, shkroi në X zëdhënësi i talibanëve, Zabihullah Mujahid. Talibanët pretenduan po ashtu se kanë vrarë “një numër të madh të ushtarëve pakistanezë”, kanë marrë kontrollin e postbllqeve të tyre dhe qendrave, ua kanë konfiskuar armët dhe tanket dhe kanë “shkatërruar” shumicën e ndërtesave të tyre ushtarake. Zyrtarët pakistanezë fajësuan

talibanët për përleshjet dhe thanë se katër civilë janë plagosur në anën e tyre të kufirit. “Forcat talibane sulmuan një postbllok pakistanez afër qarkut Çaman”, tha për agjencinë Reuters, Habib Ullah Bangulzai, administrator i këtij qarku të Pakistanit. Luftimet kanë vazhduar për rreth pesë orë mëngjesin e së mërkurës, tha ai, duke shtuar se forcat pakistaneze “zmbropsën” sulmin. Edhe pse vazhdimisht ka përleshje mes forcave të sigurisë të të dyja shteteve përgjatë kufirit të tyre të kontestuar – të gjatë 2.600 kilometra – luftimet e javës së

kaluar ishin më të ashprat që kur talibanët morën pushtetin në Kabul më 2021. Këto dy shtete fqinje kanë mbyllur disa pikëkalime kufitare pas përleshjeve të javës së kaluar, duke shkaktuar ndërprerje të tregtisë dhe duke lënë të bllokuar kamionë me mallra në dy anët e kufirit. Pakistani është burimi kryesor për mallra dhe furnizime ushqimore që transportohen përmes rrugëve tokësore në Afganistan. Përleshjet e javëve të kaluara rritën shqetësimet ndërkombëtare, me Kinën që u kërkoi të dyja shteteve të mbrojnë qytetarët e tyre dhe investimet, me Rusinë që bëri

thirrje për përmbajtje dhe me presidentin amerikan, Donald Trump, që deklaroi se ai mund të ndihmojë në dhënien fund të konfliktit. Tensionet mes Pakistanit dhe Afganistanit gjatë këtij muaji përkojnë me vizitën që zhvilloi ministri i jashtëm taliban, Amir Khan Muttaqi, në Indi – rivalen e përbetuar të Pakistanit. India dhe Afganistani, gjatë vizitës së Muttaqit, vendosën që të përmirësojnë raportet, me Nju Delhin që tha se do të rihapë ambasadën në Kabul. Ndërkaq, talibanët afganë po ashtu njoftuan se do të dërgojnë diplomatë në Indi./REL

Trump i zhgënjyer me Putinin: Nuk do ta ndalë luftën, po bën figurë të keqe

Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, kritikoi homologun rus Vladimir Putin gjatë një deklarate për gazetarët në Shtëpinë e Bardhë të martën, duke thënë se udhëheqësi rus thjesht nuk dëshiron t'i japë fund luftës në Ukrainë. “Shikoni, jam shumë i zhgënjyer sepse unë dhe Vladimiri kemi pasur një marrëdhënie shumë të mirë, ndoshta ende e kemi. Nuk e kuptoj pse ai vazhdon me këtë luftë. Kjo luftë ka qenë shumë e keqe për të. Po hyn në vitin e katërt të një lufte që duhet ta



kishte fituar. Duhej ta kishte fituar për një javë. Tani po hyn në vitin e katërt. Ai ka humbur ndoshta një milion e gjysmë ushtarë, afërsisht. Sigurisht, në kuptimin e të plagosurve, njerëzve pa këmbë, pa duar dhe të gjitha gjërave që ndodhin në luftëra të tmerrshme. Është një luftë e tmerrshme”, tha Trump gjatë një aktiviteti me Presidentin argjentinas Javier Milei, përcjell A2 CNN. “Duhet ta përfundojë këtë luftë. Dhe e dini që tani në Rusi ka radhë të gjata për karburant, apo jo? Ka radhë të gjata. Kush do ta

kishte menduar se do të ndodhte kjo? Papritur ekonomia e tij po shembet. Dhe unë do të doja ta shihja të bënte mirë. Dua të them, kam pasur një marrëdhënie shumë të mirë me Vladimir Putinin, por ai thjesht nuk do ta mbyllë atë luftë, dhe mendoj se kjo po e bën të duket shumë keq. Mund ta përfundonte. Mund ta kishte përfunduar shpejt. Dhe duhet të them, e vlerësoj, sepse kush do ta kishte menduar që Ukraina do të mund të luftonte kundër Rusisë për katër vjet, deri në një pikë ku janë baraz”.



Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelenskiy, pritët të takohet me Presidentin Donald Trump në Uashington të premten, ku të dy

do të diskutojnë për mbrojtjen ajrore të Ukrainës dhe aftësitë e saj për goditje në distanca të gjata.



28 kombëtare siguruan kualifikimin në Botëror

PRISHTINË, 15 TETOR - Ka shkuar në 28 numri i ekipeve kombëtare që e kanë siguruar kualifikimin në Kampionat Botëror. Dritarja e FIFA-s për ndeshjet e tetorit është mbyllur përfundimisht të martën mbrëma, ndërsa janë zbuluar emra të rinj që e prejnë biletën për Kupën e

Botës, e cila do të mbahet vitin tjetër në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada dhe në Meksikë. Nga Evropa vetëm Anglia e ka siguruar pjesëmarrjen në Botërorin 2026, ndërsa kanë mbetur edhe 15 vende të lira nga Kontinenti i Vjetër, ku një vend në garën më të madhe të

futbollit botëror po e kërkojnë edhe Kosova dhe Shqipëria. Në Botërorin e vitit të ardhshëm do të marrin pjesë 48 kombëtare, që nënkupton se të lira janë edhe 20 vende. Kombëtarët e kualifikuara tashmë në Botëror janë: ShBA-ja, Kanadaja, Meksika, Anglia, Arabia Saudite,

Australia, Irani, Japonia, Jordania, Katari, Koreja e Jugut, Uzbekistani, Afrika e Jugut, Algjeria, Bregu i Fildishtë, Egjipti, Gana, Kepi i Gjellbër, Maroku, Senegali, Tunizia, Argjentina, Brazili, Ekuadori, Kolumbia, Paraguai, Uruguai dhe Zelandë e Re.



KOSOVA U21 SHËNON FITORE BINDËSE NDAJ SAN MARINOS

PRISHTINË, 15 TETOR - Kombëtarja e Kosovës U21 ka realizuar fitore bindëse ndaj San Marinos me rezultat 7:, në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2027 në ndeshjen e zhvilluar të martën në mbrëmje në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kjo ishte fitorja e parë për Kosovën U21 në këtë cikël kualifikues, pas barazimit si mysafir enë Rumani dhe humbjes ndaj Spanjës në shtëpi. Djelmoshat e përzgjedhësit Afrim Tovërlani kanë zhvilluar një lojë dominuese nga fillimi

deri në fund, duke treguar cilësi, efikasitet dhe shpirt të lartë gare. Kosova e ka nisur furishëm ndeshjen. Në minutën e 12-të ka kaluar në epërsi me golin e Eliot Bujupit. Vetëm katër minuta më vonë Leon Frokaj ka shënuar për 2:0, ndërsa në minutën e 20 Hekuran Berisha ka realizuar për 3:0, rezultat me të cilin është mbyllur pjesa e parë. Në pjesën e dytë "Dardanët" kanë vazhduar me të njëjtin ritëm. Berisha në minutën e 59 ka shënuar golin e dytë personal dhe të katërt për

Kosovën, ndërsa vetëm tre minuta më vonë Lirim Jashari, i cili sapo ka hyrë në lojë, e ka çuar rezultatin në 5:0. Julind Selmonaj në minutën e 75-të ka realizuar për 6:0, ndërsa rezultatin përfundimtar 7:0 e ka vulosur Frokaj në minutën e 83-të me golin e dytë. Pas kësaj fitoreje, Kosova U21 ka grumbulluar katër pikë dhe renditet në vendin e katërt të Grupit A. Në muajin nëntor, "Dardanët" e rinj do të zhvillojnë edhe dy ndeshje të tjera kualifikuese, të dyja si mysafirë, ndaj Qipros dhe Finlandës.



ELSEID HYSAJ KALON EDHE LORIK CANËN, BËHET LOJTARI ME MË SHUMË PARAQITJE NË HISTORINË E SHQIPËRISË

Tiranë, 15 tetor - Elseid Hysaj ka hyrë zyrtarisht në histori, duke u bërë lojtari me më shumë paraqitje në Kombëtaren e Shqipërisë. Mbrojtësi shkrokan ka arritur shifrën rekord prej 94 ndeshjesh, duke kaluar çdo emër tjetër që ka veshur fanellën e Shqipërisë. 31-vjeçari u inkadruar në minutën e 77 në miqësoren ndaj Jordanisë, duke shijuar këtë moment të veçantë në karrierën e tij. Në ndeshjen e kaluar kundër Serbisë, Hysaj kishte barazuar rekordin e Lorik Canës, me nga 93 ndeshje me

"kuqezinjtë". Ky është një moment historik për mbrojtësin që aktivizohet me Lazio në Serinë A dhe një shembull i përkushtimit dhe vazhdimësisë në shërbim të kombëtares shqiptare. Që nga debutimi i tij në vitin 2013, Hysaj është bërë një shtyllë e mbrojtjes dhe një lider i vërtetë në fushë, duke kontribuar në arritjet më të mëdha të Kombëtares, përfshirë pjesëmarrjen historike në Euro 2016 dhe Euro 2024. Me këtë rekord, Elseid Hysaj vulos emrin



në librin e artë të Kombëtares shqiptare dhe mbetet një figurë kyçe për ekipin edhe për të ardhmen.

PRESIDENTI I FIFA-s PËRFSHIN EDHE KOSOVËN NË MESIN E KOMBËTAREVE QË PO SHKËLQEJNË DHE RRUGËTOJNË DREJT BOTËRORIT

GINEVË, 15 TETOR - Presidenti i shtëpisë së futbollit botëror, FIFA, Gianni Infantino, e ka përfshirë edhe Kombëtaren e Kosovës në postimin e tij të veçantë në rrjete sociale. Në "Instagram" ai ka postuar disa fotografi të disa kombëtareve të cilat arritën rezultate të mira gjatë këtij muaji. Ndër to ishte edhe ajo e Kosovës, e cila ka shënuar fitore të madhe ndaj Suedisë. "Skuadrat evropiane kanë kënaqur tifozët në mbarë kontinentin gjatë ndeshjeve më të fundit kualifikuese për Kupën



e Botës 2026 të FIFA-s, teksa gara për t'u kualifikuar në Kanada, Meksikë dhe Shtetet e Bashkuara bëhet edhe më emocionuese!", ka shkruar Infantino.

Ronaldo përmbys historinë e futbollit me një tjetër rekord botëror

Lisbonë, 15 tetor - Cristiano Ronaldo ka vendosur një tjetër rekord historik. Ylli portugez ka shënuar dy gola në barazimin ndaj Hungarisë. Falë këtyre dy

realizimeve, kapiteni i Portugalisë ka arritur në 41 gola në kualifikimet e Kupës së Botës, duke kaluar sulmuesin guatemalas, Carlos Ruiz, i cili kishte 39.

Në podium qëndron edhe Lionel Messi, me 36 gola, që mban vendin e tretë në renditjen historike. Nga futbollistët evropianë, përveç Ronaldos, në listën e 25 më të

mirëve renditen: Robert Lewandowski (33 gola), Edin Džeko (29), Andriy Shevchenko (26), Harry Kane (23) dhe Memphis Depay (22).



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare

Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company

TREPÇA

Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qera te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, Zyra e shitjes me datën 15.10.2025 bënë shpallje publike për dhënin e pronës së paluajtshme me qera.

Shpallje Publike T-25-10

Autoriteti Kontraktues (AK): Trepça Sh.A.

Adresa e AK: Parku Industrial
MITROVICË
40000

Personi Kontaktues: Arjanit Ademi

E-mail: arjanit.ademi@trepcasha.com

Telefoni: +381 28 538 050

Faks: +381 28 539 202

Shpallja Publike

Qëllimi i ofertës:

- Dhënie me qera e hapësirave

- Sipërfaqja dhe çmimi fillestar

Loti 1

Nr	Parcel sipërfaqe e Mbuluar garazha dhe e pambuluar ne Terminalin Doganor	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	P-71208128-01090-7	273.16	1.5	409.74	73.75	36.87	446.61

Ri Shpallje Publike T-25-9

Loti 1

Nr	Objekti - Magjistralja Mitrovicë-Bajgorë	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	P-71208128-00704-2	260.00	0.75	195	35.100	17.55	212.55

Loti 2

Nr	Objekti - Depo - PIM	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	P-71208128-001090-1	550.00	0.70	385	69.300	34.65	419.65

Loti 3

Nr	Magjistrale te Adriatikut	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	P-71208128-001090-2	9178.00	0.59	5415.02	974.704	487.35	5902.37

Loti 5 (kjo hapsire mund te ndahet edhe ne sip. me te vogël, varësisht nga kërkesa)

Nr	Hapësira - Badovc	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	P-73414004-00216-1	730.00	0.50	365	65.700	32.85	397.85

Loti 6 kjo hapsire mund te ndahet edhe ne sip. me te vogël, varësisht nga kërkesa)

Nr	Hapësira - Stanterg	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	P-71208112-00124-0	700.00	0.30	210	37.800	18.90	228.90

Loti 7

Nr	Hapësira - Stanterg	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	P-71208112-00131-0	30.00	0.80	24	4.320	2.16	26.16

Loti 8

Nr	Hapësira - Stanterg	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	P-71208112-00131-0	30.00	0.80	24	4.320	2.16	26.16

Loti 9

Nr	Hapësira - Stanterg	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	P-71208112-00131-0	30.00	0.80	24	4.320	2.16	26.16

Loti 10

Nr	Objekti - Stanterg	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	P-71208112-00131-0	30.00	0.80	24	4.320	2.16	26.16

Loti 13

Nr	Hapësira - FPP, P-71208072-2649-0	Sipërfaqja (m²)	Çmimi neto (€)	Çmimi pa TVSH	TVSH 18 %	Tatimi 9 %	Totali për pagesë
1	Sip. e mbuluar	160.00	2.00	320	57.600	28.80	348.80
2	Sip. e pambuluar	100.00	0.50	50	9.000	4.50	54.50

Kriteret e Dhënies:

Data e shpalljes:

Sqarimi:

Kërkesa për pjesëmarrje:

Dorëzimi i ofertave:

Afati i fundit i dorëzimit:

Vendi i dorëzimit:

Dhënia e kontratës do të bazohet në çmimin më të lartë

15.10.2025

deri me 22.10.2025

Data(t) për kërkesës deri: 30.10.2025

Bëhet në e-Mail: poshtë shënuar ose në Zyrën e shitjes dhe qirasë.

Dorëzimi i ofertave bëhet ne formë fizike (zarf te mbyllur) (Originali dhe Kopja)

30.10.2025 në 11:00

Zyra e shitjes dhe qirasë të Trepça Sh.A. Parku Industrial, Mitrovicë (PIM)

Kërkesat minimale të kualifikimit:

1. Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit të entitetit.

2. Kopje të certifikatës së regjistrimit për TVSH (vetëm për ofertuesit vendor)

3. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore se operatori ekonomik në fjalë nuk është në vonës në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të njoftimit për kontratë.

4. Nuk ka obligime ndaj Trepçës të pa paguara.

Shënime shtesë:

Çmimi i ofertës: Çmimi i ofruar nga O.E të interesuar do të jetë më i madh apo i barabartë me çmimin e parashikuar nga Autoriteti Kontraktues - Trepça Sh.A.

Obligimet: Ofertuesi fitues do të bartë të gjitha obligimet e investimeve si dhe te gjitha shpenzimet administrative, komunale dhe shpenzimet tjera të cilat dalin mbas lidhjes së kontratës.

Oferta: Duhet të përfshijë çmimin për m² duke përfshirë TVSH-në dhe Çmimin total shih Aneks1.

Pagesa: Të gjitha pagesat do të bëhen në EURO, pa ndalesë, kundërkërkesë ose çfarëdo zbritje në llogarinë bankare të Trepça Sh.A.

Operatorët ekonomik: që nuk i paraqesin të gjitha të dhënat për formimin e çmimit Aneks 1 dhe deklarimi Aneksi 2 Ofertat e tyre nuk do të shqyrtohet.

Aneksi 1

OFERTA

Emri i OE:	
Loti	
Kodi (T)	

D=a*c	Vlera e qerasë për sipërfaqen e mbuluar (€)	
a	Sipërfaqe m²	
b	Çmimi për m²	
c = a*b	Vlera pa TVSH	
d = c * 18 %	TVSH 18 %	
e = c + d	Total	
f = c * 9 %	Tatimi - 9 %	
g = e - f	Për pagesë	

Tatimi në qira prej 9% gjithashtu bije në barrë të qiramarrësit dhe pagesën e saj e bënë qiramarrësi

Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneksi 2

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *operatorin ekonomik që paraqitet* deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Rregulloren për dhënie me qira te pronës se paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në rregulloren dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklarata që përmban informata përbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
E-mail:	
Tel:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Aneks 3.

Pjesëmarrja

Pjesëmarrja - Marrja e Aplikacionit mund të behet deri me datën 30.10.2025 përmes e-mail ose në Zyren e Shitjes.

Aneks 4.

Përshkrimi i Aseteve

Përshkrimi i aseteve të shënuara më poshtë shërbejnë vetëm për qëllime të informimit dhe Autoriteti Kontraktues nuk ofron garanci të saktësisë së përshkrimit. Këto asete jepen në kushte të gjendjes aktuale “ashtu siç janë dhe ku janë” dhe autoriteti kontraktues nuk ofron Garancion në lidhje me gjendjen e aseteve.

Tenderuesi bartë rrezikshmërinë e plotë për gjendjen e aseteve.

Objekti është i ndarë në lote,

Trepça Sh.A. përmes këtij njoftimi përcakton kushtet dhe termet dhënës me qiratë objekteve dhe hapësirave sipas tenderit me metodën e çmimit ekonomikisht më të lartë, bazuar në parametrat e poshtëshënuar që përcaktojnë formimin e çmimit ekonomikisht më të lartë.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

NJOFTIM PUBLIK

Në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtim dhe Banim është dorëzuar kërkesë për Kushte Ndërtimore nga Great Plains L.L.C – Prishtinë me nr. të protokolit 5210/25 të datës 04.07.2025 për parcelat kadastrale ku planifikohet të ndërtohet parku solar dhe infrastruktura përcjellëse dhe ndodhen të gjitha në Zonën Kadastrale Lubovë 70806030, me numër të parcelave: 00015-3; 00016-0; 00018-0; 00019-0; 00020-0; 00029-1; 00029-2; 00029-3; 00030-1; 00030-2; 00030-3; 00030-4; 00030-5; 00030-6; 00030-7; 00030-8; 00035-0; 00036-0; 00037-1; 00037-2; 00038-0; 00039-0; 00040-0; 00041-1; 00041-2; 00043-3; 00044-0; 00045-0; 00046-1; 00046-2; 00047-1; 00047-2; 00048-0; 00049-1; 00049-2; 00049-3; 00055-0; 00056-1; 00056-2; 00057-1; 00057-2; 00057-3; 00058-0; 00068-0; 00069-0; 00070-0; 00071-0; 00072-1; 00072-2; 00078-1; 00078-2; 00078-3; 00078-4; 00079-0; 00081-0; 00082-0; 00084-0; 00085-0; 00358-0; 00359-0; 00360-0; 00361-1; 00361-2; 00362-1; 00363-1; 00363-3; 00365-0; 00366-0; 00367-0; 00370-0; 00371-0; 00372-0; 00373-2; 00373-3; 00381-0; 00382-0; 00383-0; 00384-0; 00385-1; 00385-2; 00387-1; 00387-2; 00387-3; 00387-4; 00387-5; 00387-6; 00387-7; 00388-1; 00388-2; 00388-3; 00520-3; 00521-0; 00523-0; 00524-1; 00525-0; 00536-0; 00538-2; 00539-1; 00539-2; 00539-3; 00539-4; 00546-1; 00546-2; 00546-5; 00547-0; 00548-0; 00549-0; 00550-1; 00550-2; 00551-0; 00552-1; 00552-2; 00552-4; 00552-5; 00553-0; 00555-1; 00555-3; 00556-0; 00557-0; 00558-0; 00559-0; 00560-1; 00563-2; 00565-2, me sipërfaqe totale prej 109.838 m² që ndodhen në Komunën e Istogut.

Kërkesa përcakton kriteret për ndërtimin e Impianti fotovoltaiik “Parkut Fotovoltaiik në Lubovë 100 MW” Z.K. Lubovë- Istog” për gjenerimin e energjisë elektrike bazuar në burim të ripërtëritshëm të energjisë, energji diellore.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen deri më dt.24.10.2025 në: dkp.mmph@rks-gov.net.

Dokumentet e publikuara:	
Kushtet Ndërtimore të propozuara: Great Plains L.L.C	
Situacioni i gjere dhe i ngushtë sipas projektit konceptual (format A0) që përmban informatat në vijim:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës: Arë e klasës 5, 6 dhe 7/ Shfrytëzim i përkohshëm- Prodhim i Energjisë së Ripërtitshme nga Dielli	
b. Vija rregulluese.	- m’
c. Vija e ndërtimit.	5-7 m
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	2.5-3.0 m
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor te parcelës.	2.5-3.0 m
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale. Anash të riformulohet sipas kërkesës për kushte	0.18 %
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	91.63 %
h. Përqindja e sipërfaqes bruto banuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale.	- %
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve.	7
k. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja:	Montuese
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po ☒ Jo ☐ Nuk aplikohet ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona përreth? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po ☐ Jo ☒ Nuk aplikohet ☐ Sqaro:	

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Hana Plus” SH.P.K. me pronar Zymrite Zeqiri me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811385427 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Hana Plus” D.O.O. Zymrite Zeqiri Gnjlane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811385427 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Hana Plus” L.L.C. Zymrite Zeqiri with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811385427 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Irfan Hodaj shpall te pa vlefshme dëftesën e shkollës fillore “Luigj Gurakuqi” në Nashec.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.
- Blerim Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale Teknike “Gani Qferbasha” Prizren.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.
- Samile Mullaibrahimi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m të mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.
- Muharrem Shala shpall të pavlefshme diplomën si dhe dëftesat e shkollës fillore “Mustafa Bakija”.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Shqiprim Morina shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “12 Maji”.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.
- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
0.5L